



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2022:079806
Datë: 15.07.2022
Numri i dokumentit: 03234269
P.nr.65/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Lulzim Paçarizi, si dhe sekretaren juridike Behije Karaçica, në çështjen penale ndaj të akuzuarit B. K. për shkak të veprës penale kanosjes nga neni 181 parg.1 te KPRK-së, e sipas aktakuzës së PTH-Gjakovë me numër PP/II.nr.300/22 te dt.14.04.2022, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar, të dt.12.07.2022, ku prezent ishin Prokurori i shtetit Sadri Alija , si dhe i akuzuari B.K., me dt.13.07.2022 shpallë, ndërsa me dt. 15.07.2022, e përpilon këtë:

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI: B.K., nga i ati Sh. dhe e ëma Gj. e lindjes P., i lindur më datën, në fsh.G., Komuna D. ku edhe jeton, Komuna M. me nr. personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka kryer shkollën mesme, i pa martuar, punëtor fizik, i gjendjes së dobët ekonomike.

Ë S H T Ë F A J T O R

Për shkak se me dt.05.02.2022 rreth orës 01:00/h, në Rr. „S.” Malishevë, me qëllim të frikësimit e kanos tjetrin me fjalë se do t'i shkaktojë ndonjë të keqe dhe atë të dëmtuarës/bashkëshortes së tij L. Sh., në atë mënyrë që natën kritike pasi e dëmtuara e përfundon punën në lokalin ku punon si këngëtare, i pandehuri B.e pret e më pas e ndjek me veturë derisa ajo e ngiste veturën e saj, e më pas e thirr në telefon dhe i drejtohet me fjalët „ose leje punën ose skam me ta lan vendin vend” me ç’rast tek e dëmtuara ka shkaktuar frikë dhe ankth dhe pasiguri për jetën e saj.

-me këto veprime ka kryer veprën penale, Kanosje nga neni 181 parg.1 te KPRK-së.

Andaj gjykata konform nenit 4,7,17, 38, 39, 40, 43, 69 e nenit 181 par.1 të KPRK-së, (Kodit nr. 06/L-074) si dhe nenit 493 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të njëjtit i`a shqipton:

DËNIMIN ME GJOBË

Ashtu që e dënon me dënim me gjobë në lartësi prej **300 €** (treqind) euro, të cilën shumë i akuzuari është e obliguar që ta paguaj në xhirollogarinë e kësaj gjykate në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi i shqiptuar më gjobë do të iu zëvendësohet me dënim burgu, në kohëzgjatje prej 15 ditësh, dukë llogaritur çdo 20 euro në një ditë burgu.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t'ia paguaj shumën prej 20 euro, shumën prej 30 euro për programin mbi kompensimin e viktimave të krimit, ndërsa shpenzimeve të procedurës penale nuk ka pasur, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën ekzekutimi do të behet me detyrim.

E dëmtuara L. Sh. nga fsh. Sh. K. S., lidhur me kërkesën pasurore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt civil.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.300/22 të dt.14.04.2022, e ka akuzuar të akuzuarin B. K. për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 181 par.1 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor si dhe administrimit të provave, të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj në bazë të ligjit.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt.12.07.2022, ku prezent kanë qenë, prokurori i shtetit Sadri Alija, i akuzuari B. K., andaj ka pasur kushte për mbajtjen e shqyrtimit fillestar.

I akuzuari B.K. në shqyrtimin fillestar është deklaruar i fajshëm, për veprën penale për të cilën ngarkohet, duke shtuar së më vjen keq për rastin i cili ka ndodhur, po ashtu unë jam në gjendje edhe të kërkoj falje për rastin i cili ka ndodhur, ky ka qenë rasti im i parë që kam ra ndesh me ligjin, andaj kërkoj nga gjykata që të merren parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimit dhe të më shqiptohet një dënim sa më i butë, pasi që jam mbajtës i familjes, po ashtu gjykatës i premtoj që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm që të mos kryej kurrfarë vepra penale.

Prokurori i shtetit Sadri Alija në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimit e fajësisë dhe se pranimi i fajësisë mbështetet në provat që gjenden në shkresat e lëndës, dhe meqenëse i akuzuari e pranoi fajësinë në mënyrë vullnetare, pa presion dhe pa shtytje, me rastin e shqiptimit të dënimit gjykata ti ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, dhe i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit, si dhe të obligohet në kompensimin e shpenzimeve procedurale.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga e tw akuzuarit i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPPRK-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoj se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga

prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike

- Raporti i oficerit A. K. ID#... i dt.05.02.2022;
- Deklarata e të dëmtuarës L. Sh. dhënë në polici më dt.05.02.2022;
- Deklarata e dëshmitares F. T. dhënë në polici me dt.05.02.2022;
- Deklarata e të pandehurit B. K. dhënë në polici me dt.05.02.2022 si dhe
- Shkresat tjera në lëndë

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 181 par.1 të KPRK-së, është parashikuar se „ 1. Kushdo që seriozisht e kanos personin tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do t'i shkaktoj ndonjë të keqe me qëllim të frikësimit ose të shkakimit të ankthit te personi i tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.

5. Vendimi i gjyqtarit të vetëm gjykues.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarin B. K., e ka shpallur fajtorë për veprën penale për të cilën ngarkohet, nga se në veprimet e tij të përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit, formohen të gjitha elementet e veprës penale kanosje nga neni 181 par.1 KPRK-së, (kodi nr. 06/L074), për këtë ka vendosur që të akuzuarën ta gjykoj në bazë të ligjit, e me parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 të KPRK-së (kodi nr. 06/L074), të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit, pranimin e fajësisë, pendimin e tij, jeton në familje prej 10 anëtarëve, i gjendjes së dobët ekonomike dhe mbajtës i familjes, është hera parë që ka rënë ndesh me ligjin, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej kurrfarë vepre penale, kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me gjobë në shumën prej 300 (treqind) euro, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar që ta paguaj 15 ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën dënim i shqiptuar me gjobë do të zëvendësohet në dënim burgu, dënim ky me të cilin do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 të KPRK-së, dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

7. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimin mbi udhëzimin në kontestin civil gjykata e mbështeti në nenin 463 par.1 dhe.2 të KPPK-së, ndërsa vendimin mbi paushallin gjyqësor dhe shpenzimet e procedurës penale gjykata e mbështeti në nenin 453 par.4 të KPPK-së.

Vendimin në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit nr.05/L036 për kompensimin e viktimave të krimit.

Me sa u tha me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.65/22, me dt.13.07.2022.

Sekretarja juridike
Behije Karaçica

Gjyqtari i vetëm gjykues
Lulzim Paçarizi

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, nëpërmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.